



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIONI KOSOVAR kundër KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA BORBU PROTIV KORRUPCIJE NA KOSOVU
KOSOVO ANTI-CORRUPTION AGENCY

RAPORTI VJETOR
I
AGJENSIONIT
KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT

1 janar – 31 dhjetor 2008

PËRMBAJTJA E TABELES

HISTORIKU I AKK-SË	3
PJESA E PËRGJITHËSHME	4
KËSHILLI I AGJENSIONIT KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT	5
ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE STAFI I AGJENSIONIT	5
LUFTIMI I KORRUPSIONIT	6
i. Aktiviteti i departamentit të hetimeve në fuqizimin e ligjit	6
ii. Pasqyra e përgjithshme e rasteve në AKK për vitin 2008	10
PARANDALIMI I KORRUPSIONIT	13
i. Mbikëqyrja e Pasurive	14
ii. Kontrolli i Formularëve të Deklarimit të Pasurive	16
iii. Pranimi i Dhuratave	18
iv. Parandalimi i konfliktit të interesit	18
EDUKIMI I PUBLIKUT	20
LEGJISLACIONI/HARMONIZIMI I TIJ	21
STRATEGJIA KUNDËR KORRUPSIONIT DHE PLANI I VEPRIMIT	22
ADMINISTRATA/BUXHETI	22
i. Buxheti për vitin 2008	23
ii. Zyra e Prokurimit	24
iii. Aktivitetet e zyrës së Prokurimit	24
iv. Burimet Njerëzore/Personeli	25
ZYRA PER MARRËDHENIE ME PUBLIKUN	25
i. Takime me gazetarë dhe qytetarë	26
ii. Konferencat dhe komunikata per shtyp	26
iii. Monitorimi i mediave ne periudhen janar - dhjetor '08	26
iv. Faqja zyrtare e internetit	28
v. Aktivitetet dhe Bashkëpunimi	28
PROBLEMET	29
SFIDAT E SË ARDHMËS	30
PËRFUNDIM	31
SHTOJCA 1: ORGANOGRAMI	32
SHTOJCA 2: LISTA E TRAJNIMEVE	33

HISTORIKU I AKK-SË

Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit është institucion i pavarur, i konceptuar si mekanizmi themelor në parandalimin dhe luftimin e fenomenit të korrupsionit dhe koordinimin e politikave anti-korrupsion në Kosovë. Agjensioni ushtron përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin kundër Korrupsionit (2004/34), është themeluar në korrik 2006 dhe ka filluar funksionalitetin e tij në 12 shkurt 2007.

Qëllimi dhe puna e Agjencionit është e përqendruar në zbulimin dhe hetimin e rasteve korruptive, përpjekjeve për parandalimin dhe luftimin e fenomenit të korrupsionit, për të ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë e të përparuar kosovare dhe që bazohet në shtetin e së drejtës.

Ligji aktual kundër korrupsionit, që përbën bazën ligjore të funksionimit të Agjencionit, parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve administrative të korrupsionit publik, analizimin dhe eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, papajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e punëve në detyrë, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publik.

Fondet për funksionimin e AKK-së sigurohen nga Buxheti i Kosovës, ndërsa ndryshe nga vitet paraprake gjatë vitit 2008 buxheti i AKK-së ishte i alokuar nga Qeveria ashtu siq është kërkuar dhe si i tillë ishte në përputhje me nevojat e institucionit që nënkuptonë edhe funksionimin normal të Agjencionit dhe ruajtjen e pavarësisë së tij të plotë.

PJESA E PËRGJITHËSHME

Korrupsioni në Kosovë vazhdon të jetë një fenomen i keq që po përpiqet ti zë frymën zhvillimit të shoqërisë së shtetit të Kosovës në tranzicion. Megjithatë themelet e shtyllave për parandalimin dhe luftimin e tij janë ngritur fuqishëm. Agjensioni kosovar Kundër Korrupsionit si mekanizëm qendror anti-korrupsion gjatë vitit 2008 demonstroj fuqinë e plotë të përbaljes me këtë fenomen duke iu bërë pengesë e madhe rritjes së tij përmes shumë aktiviteteve të cilat çdo ditë po përmirësojnë imazhin e Kosovës dhe po nxisin besimin e qytetarëve si ndaj AKK-së ashtu edhe tek institucionet e vendit.

Çdo vit që kalon është i rëndësishëm në jetën e një institucioni, por ka vite që mbeten në kujtesë. Viti 2008 për AKK-në mbetet i tillë, pasi ai lidhet me disa momente të rëndësishme për punën e AKK-së.

Moment shtesë që i dha pamje të veçantë AKK-së është edhe konsolidimi i brendshëm (plotësimi i stafit) të AKK-së, dhe fillimi i përqendrimit të gjithë energjisë së këtij institucioni, esencialishtë në përmbushjen e misionit të vetë. Kjo përmes prioriteteve të përcaktuara, zbatimi i strategjive dhe politikave të mirëfillta për parandalimin dhe çrrënjosjen e korrupsionit, promovimin e transparencës dhe integritetit të institucioneve qendrore si dhe përfshirjen e publikut në përpjekjet anti-korrupsion.

AKK-ja është një institucion që relativisht ka krijuar një përvojë të mirë në marrjen e hapave konkrete kundër veprimeve të dyshuara korruptive, ndërgjegjësimin për një shoqëri të pa korruptuar tek nëpunësit civil, zyrtarët e lartë, sektori publik, media dhe shoqëria civile si dhe publiku në përgjithësi. Pas përgaditjes së strategjisë kombëtare kundër korrupsionit, AKK ka vendosur një bazë shumë të shëndoshë të bashkëpunimit të ndërsjellët midis institucioneve, mekanizmave dhe partnerëve për të nxjerrë një dokument tjetër të rëndësishëm, Planin e Veprimit kundër-Korrupsionit.

Ky është raporti i dytë vjetor që Agjensioni i paraqet Kuvendit të Kosovës, ndërsa pasqyron aktivitetet dhe iniciativat e ndërmarra gjatë vitit 2008, që në esencë reflektojnë në mënyrë të detajuar detyrat e kryera të AKK-së të cilat kanë qenë të përqendruara në tre shtylla kryesore:

Strategjia e punës së AKK-së mbështetet në tre shtylla kryesore të cilat ndihmojnë në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi që rrjedhin nga Ligji kundër Korrupsionit si dhe në arritjen e:

- Zbatimit të ligjit ku përfshihen përcjellja e informatave për korrupsion në Prokurorinë Publike të Kosovës si dhe hartimi i ligjeve të reja për plotësimin e kornizës ligjore në këtë fushë, përgatitja dhe zbatimi i strategjisë dhe planit kombëtar të veprimit anti-korrupsion;
- Parandalimit ose eliminimit të shkaqeve të korrupsionit përmes kryerjes së deklaramit të pasurisë së zyrtarëve të lartë, parandalimit të konfliktit të interesit dhe regjistrimit të dhuratave të pranuar nga personat zyrtar; dhe
- Edukimit të zyrtarëve të administratës publike dhe qytetarëve mbi kornizën ligjore dhe mekanizmat aktuale anti-korrupsion, informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut si dhe ngritjen profesionale të stafit.

Poashtu ky raport paraqet një prezantim gjithëpërfshirës dhe aktual mbi kuadrin ligjor anti-korrupsion, iniciativat e ndërmarra në plotësimin e tij, mekanizmat institucional të përfshirë në procesin e përmirësimit dhe kompletimit të këtij kuadri, për ta sjellë legjislacionin kosovar në të njëjtin standard me atë ndërkombëtar.

Raporti është një dritare e hapur përmes së cilit publiku mundë të shoh progresin e bërë gjatë periudhës së raportimit si dhe të njohë problemet e hasura gjatë zbatimit të detyrave dhe aktiviteteve të kryera nga Agjensioni.

Një pasqyrë reale të gjithë punës së bërë për vitin 2008 do ta gjeni në këtë raport vjetor, i cili tashmë është bërë një pikëtakim tradicional me të gjithë bashkëpunëtorët si dhe ata që duan të dine më shumë për Agjencionin Kosovar Kundër Korrupsionit.

KËSHILLI I AGJENSIONIT KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT

Puna e Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit mbikëqyret nga Këshilli i Agjensionit i cili është një organ kolegjal me nëntë përfaqësues të cilët vijn nga nga: Kuvendi i Kosovës, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, Gjykata Supreme, Prokuroria Publike e Kosovës, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Shoqëria Civile. Anëtarët e Këshillit kanë një mandat prej dy vitesh në detyrë. Këshilli aktual fillojë punën në qershor të vitit 2008 duke trashëguar kështu një këshill paraprak të cilit i përfundojë mandati në shkurt të vitit 2008. Gjatë këtij mandati Këshilli ende nuk është plotësuar tërsisht pasi që mungonë përfaqësuesi nga shoqëria civile. Gjatë periudhës së raportimit Këshilli ka realizuar 18 takime. Sikurse këshilli paraprak edhe ky aktual do ta ketë mandatin dy vjeçar.

Agjensioni bazuar në kuadrin ligjor në mënyrë periodike raporton tek Këshilli i Agjensionit çdo gjashtë muaj në lidhje me përmbajtjen dhe shtrirjen e mbikëqyrjes së pasurive si dhe për gjetjet e Agjensionit në lidhje me papajtueshmërinë, konfliktin e interesave, dhuratat dhe hetimet e përfunduara si dhe punën dhe aktivitetet e detajuara të kryera nga Agjensioni gjatë periudhës së raportuar.

Deri më tani, Agjensioni ka paraqitur në Këshill një raport vjetor përkatësisht për periudhën janar – dhjetor 2007, dhe tri raporte gjashtë mujore, për periudhën Korrik – Dhjetor 2006, Janar - Korrik 2007, dhe Janar Korrik 2008. Raporti vjetor i punës së AKK-së për vitin 2008 do ti paraqitet dhe dorëzohet Këshillit, ndërsa pas miratimit nga ana e Këshillit ai kalon në Kuvendin e Kosovës.

ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE STAFI I AGJENSIONIT

AKK-ja tani nuk vuan nga numri i pamjaftueshëm i zyrtarëve, pasi që gjatë këtij viti është kompletuar i tërë stafi. Aktualisht në Agjensionin Kosovar kundër Korrupsionit janë të punësuar 35 zyrtarë numër ky që është miratuar edhe nga Kuvendi i Kosovës (**shiko strukturën përkatëse në Shtojcën 1**).

Në këtë drejtim gjithsesi, duhet përmendur faktin së asistencë teknike profesionale gjatë vitit 2008, Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit i është dhënë edhe përmes projekteve CBF (projekt i financuar nga Zyra e UNDP-së në Kosovë dhe Fondacioni Soros në Kosovë) dhe CBEI (projekt i financuar nga EAR dhe menaxhuar nga Zyra e UNDP-së në Kosovë) të cilët kanë bërë të mundur alokimin e 4 këshilltarëve (2 këshilltarë të CBF-it më kohë të plotë deri në muajin mars 2008 dhe 2 këshilltarë të CBEI-t më kohë të pjesshme deri në muajin shtator). Këta i ofruan Agjensionit asistencë në hartimin e politikave kombëtare anti-korrupsion, strategjive dhe planeve të veprimit, ngritjen dhe ndërgjegjesimin e publikut mbi punën e këtij institucioni të ri dhe inkurajimin për të raportuar rastet korruptive, plotësimin e kornizës ligjore anti-korrupsion, etj.

Asistencë teknike dhe këshilldhënia e këshilltarëve është e pranishme në çdo aktivitet apo iniciativë të ndërmarrë nga Agjensioni.

Asistencë në fjalë ka pasur disa shikëputje p.sh, asistencë e këshilltarëve të CBF-it ka përfunduar në mars 2008, por Fondacioni SOROS vendosi që të të ndihmojë AKK-në duke i dhënë asistencë përmes këshilltarit rajonal, ndërsa UNDP-ja nga gushti i dha ndihmën e vetë përmes projektit Iniciativa Kosovare për Transparencë, duke i ofruar këshilltarin për çështjet e marrëdhënieve me publikun.

Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit e organizon punën e tij në bazë të Rregullave të Brendshme të Funkcionimit të Agjensionit. Këto rregulla pasqyrojnë në mënyrë të detajuar përgjegjësitë e çdo zyrtari në secilin divizion dhe departament.

Agjensioni është i përbërë nga tre departamente, secili departament nga dy nëndivizione dhe katër zyra të veçanta (shiko shtojcën 1). Aktualisht në mënyrë të detajuar në Agjension punojnë 35 zyrtar:

- në Departamentin për Strategjinë Anti-korrupsion dhe Hetimet Administrative, 12 zyrtar;
- në Departamentin e Parandalimit të Korrupsionit, 11 zyrtar;
- në Departamentin e Shërbimeve Administrative, 8 zyrtar si dhe
- një asistente ekzekutive, një zyrtar për marrëdhënie me publikun një zyrtar për prokurime si dhe zyrtari për arkiv.

Kapitujt në vijim paraqesin një tablo të plotë të aktiviteteve të kryera nga secili departament dhe zyrë e Agjensionit gjatë periudhës një vjeçare të raportimit, 1 Janar - 31 Dhjetor 2008.

LUFTIMI I KORRUPSIONIT

Lufta Kundër Korrupsionit nga ana e Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit zhvillohet përmes Departamentit të Hetimeve.

Departamenti i Hetimeve, ushtron përgjegjësitë e tij në kuadër të mandatit ligjor të përcaktuar me Ligjin Kundër Korrupsionit, Rregullat Procedurale të Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit, me Vendimin për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të AKK-së si dhe me aktet e tjera të brendshme të aprovuara nga Drejtori i AKK-së.

Mandati ligjor i Departamentit për Hetime konsiston në zhvillimin e aktiviteteve të mëposhtme:

- a. zhvillimin e hetimeve lidhur me akuzat e supozuara për korrupsion në ato raste kur nuk inicohet procedurë penale,
- b. përcjelljen e rasteve të hetuara tek Prokuroria Publike e Kosovës për procedim penal të mëtejshëm,
- c. bashkëpunimin me të gjitha autoritet vendore dhe ndërkombëtare të ngarkuara për zbatimin e ligjit gjatë procedurave hetimore që kryhen nga këto autoritete,
- d. përgatitjen e propozimeve për plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit,
- e. ngritjen e vetëdijes dhe sensibilizimin e opinionit në lidhje me fenomenet korruptive dhe pasojat e dëmshme që sjellin pas vetes këto fenomene,

Komformë mandatit të dhënë me Ligjin Kundër Korrupsionit dhe me legjisllacionin tjetër sekondar, puna e Departamentit të Hetimeve është përqendruar në theks të veçantë në këto drejtime:

1. Fuqizimin e ligjit ku hyn:
 - a. Zhvillimi i hetimeve për të gjitha rastet e dyshuara për korrupsion,
 - b. Plotësimi i legjisllacionit, dhe
2. Edukimin – ngritjen e vetëdijes së publikut për fenomenin e korrupsionit dhe pasojat negative të tij.

i. Aktiviteti i departamentit të hetimeve në fuqizimin e ligjit

Në fushën e fuqizimit të ligjit Departamenti i Hetimeve ka pas një aktivitet të shtuar në aspektin e pranimit të rasteve dhe zhvillimin e hetimeve në lidhje me rastet e paraqitura nga qytetarët apo të cilat janë hetuar sipas detyrës zyrtare, në vazhdim të këtij raportimi prezantojmë të dhënat në lidhje me rastet e paraqitura në Agjensionin Kosovar kundër Korrupsionit në lidhje me dyshimin për veprime korruptive si dhe hetimin dhe procedimin e tyre te prokuroritë publike kompetente dhe organet e tjera policore.

Rastet e paraqitura në Agjensionin Kosovar kundër Korrupsionit në periudhën Janar – Dhjetor 2008

Për periudhën raportuese të cilës ju referohemi në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit ka pranuar numër më të madh të rasteve të dyshuara për veprime korruptive, pra krahasuar me vitin 2007 ku ishin pranuar gjithsej 124 raste, ndërsa gjatë vitit 2008 kemi pranuar 146 raste, çka është dëshmi e rritjes së besimit të qytetarit në punën e Agjensionit për raportimin e rasteve të korrupsionit për çka ne si institucion vazhdimisht jemi angazhuar që me thjeshtësimin e procedurave të raportimit, qytetarët e vendit në mënyrë fare të thjeshtë dhe pa procedura burokratike të ju mundësohet raportimit i rasteve për të cilat ata janë në dënim.

Indeksi i rasteve të korrupsionit sipas zyrtarëve të dyshuar të institucioneve të ndryshme

Bazuar në rastet e paraqitura nga qytetarët dhe ato të hetuara ex-officio nga Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit, sipas zyrtarëve publik të dyshuar si të implikuar në veprime korruptive në lidhje me rastet, sipas kategorive të institucioneve, shpërndarja e rasteve është si në vijim.

Departamenti i Hetimeve për periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2008, gjithsejtë janë trajtuar 146 raste të dyshuara për veprime korruptive në institucionet publike të Kosovës, ku në mesin e personave të dyshuar janë të evidentuar persona zyrtar si dhe persona zyrtarë të lartë të institucioneve publike.

Rastet e hetuara për veprime korruptive në kategorinë e Institucioneve tjera, (këtu hyjnë Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Korporata Elektroenergjetike e Kosovës, Hekurudhat e Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, ish- Ndërmarrjet Shoqërore Doganat e Kosovës, Trupat Mbrojtëse të Kosovës etj), përkatësisht zyrtarëve të tyre si të dyshuar për veprime korruptive gjithsej janë të evidentuar 43 raste korruptive, shprehur në përqindje kjo shifër është 30 % të rasteve.

Në lidhje me rastet e hetuara për veprime të dyshuara korruptive ndaj personave zyrtar si dhe personave zyrtar të lartë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, kundër tyre janë paraqitur ose hetuar sipas detyrës zyrtare 37 raste korruptive apo shprehur në përqindje 25 % të rasteve.

Gjykatat në Republikën e Kosovës, përkatësisht gjyqtarët dhe personat tjerë zyrtarë në kuadër të këtyre institucioneve si të dyshuar për veprime korruptive kemi të evidentuar si të paraqitura ose të hetuara gjithsej 33 raste korruptive të dyshuara, shprehur në përqindje kjo shifër është 23 % e rasteve.

Pushteti Lokal, përkatësisht personat zyrtar të tyre si të dyshuar për veprime korruptive, kundër tyre janë hetuar sipas detyrës zyrtare ose janë paraqitur nga qytetarët 26 raste korruptive të dyshuara, kjo shprehur në përqindje del të jetë 18 % të rasteve

Prokuroritë si ajo qendrore po ashtu edhe ato në nivel të qarkut dhe komunale, krahasuar me vitin 2007 ku kishim vetëm një rast të dyshuar për veprime korruptive të zyrtarëve të institucionit të prokurorisë, për periudhën raportuese kemi të paraqitura ose të hetuara sipas detyrës zyrtare 5 raste korruptive të dyshuara shprehur në përqindje kjo shifër është 3 % të rasteve.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, krahasuar me vitin paraprak ku nuk kishim raste të paraqitura për veprime korruptive, për vitin 2008 janë paraqitur ose hetuar nga Agjensioni 2 raste korruptive të dyshuara, shprehur në përqindje kjo shifër është 1 % të totalit të rasteve të evidentuara.

Këto të dhëna të paraqitura në mënyrë grafike duken kështu:




Tabela.1. Pasqyrë e rasteve të paraqitura në Agjencion në periudhën Janar 2008 - Dhjetor 2008

Rastet e proceduara në prokuroritë publike kompetente dhe organet policore

Agjensioni konform Ligjit Kundër Korrupsionit nr. 2004/34 dhe infrastrukturës tjetër ligjore sekondare, përkatësisht pas shqyrtimit paraprak të rasteve, kur është konstatuar kompetenca e Agjencionit si dhe janë mbledhur prova të mjaftueshme për vërtetimin e fakteve të pretenduara për veprime korruptive të personave zyrtarë të institucioneve publike, gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2008 dhe përfundimit të procedurës në lidhje me hetimet e zhvilluara konform legjislacionit në fuqi në prokuroritë publike kompetente dhe organet policore janë proceduar 53 raste të dyshuara për veprime korruptive.

Ndaj zyrtarëve të Qeverisë së Kosovës (këtu përfshihen edhe ministrinë në kuadër të saj), janë dërguar në Prokurori për procedim të mëtejshëm 16 raste të dyshuara si veprime korruptive, shprehur në përqindje kjo është 29 % nga totali i rasteve të proceduara.

Ndaj zyrtarëve të institucioneve tjera publike (Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Korporata Elektroenergjetike e Kosovës, Hekurudhat e Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, ish-Ndërmarrjet Shoqërore, Doganat e Kosovës, Trupat Mbrojtëse të Kosovës etj.), ku janë 13 raste të proceduara, apo shprehur në përqindje është 25 % totalit të rasteve.

Ndaj zyrtarëve të pushtetit lokal janë dërguar në Prokurori për procedim të mëtejshëm 11 raste të dyshuara për veprime korruptive, pjesëmarrja e këtyre rasteve në totalin e rasteve të paraqitura është 21 %.

Nga rastet e dërguara në Prokurori për procedim të mëtejshëm penal, ndaj gjyqtarëve janë dërguar në Prokurori për procedim të mëtejshëm 11 raste, shprehur në përqindje kjo shifër është 21 % e totalit të rasteve.

Ndërsa që për periudhën raportuese, në lidhje me dyshimet për veprime korruptive të zyrtarëve të prokurorive qofshin ato të nivelit qendror ose niveleve të qarkut dhe komunale, janë dërguar për procedim penal të mëtejshëm 2 raste që shprehur në përqindje kjo është 4 % e totalit të rasteve të proceduara.




Tabela 2. Pasqyrë e rasteve të proceduara në prokuroritë publike kompetente Janar 2008 – Dhjetor 2008

Personat e denoncuar për veprime korruptive

Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit, nga rastet për të cilat ka zhvilluar procedurën e hetimeve në pajtim me ligjin dhe ka rezultuar me prova, me të cilat janë vërtetuar faktet për veprime korruptive të personave zyrtarë qofshin ata të institucioneve publike apo ndërmarrjeve publike, janë dorëzuar në prokuroritë publike kompetente denoncimet në lidhje me dyshimet për përfshirjen e tyre në veprime korruptive për 113 zyrtarë në institucioneve të lartpërmendura

Natyra e rasteve të proceduara dhe karakteristikat e tyre

Rastet e procedura sipas veprave penale janë 18 raste Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit, 2 raste Lidhje e kontratës së dëmshme, 14 raste përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, 5 raste marrje e ryshfetit, 3 raste nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore dhe 11 raste falsifikim i dokumentacionit zyrtar, të paraqitura sipas përqindjeve janë si në figurën me poshtë:




Tabela 3. Rastet sipas veprave korruptive të dyshuara

Në përputhje më legjislacionin në fuqi, përkatësisht Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, natyra e rasteve sipas veprave penale është si: Lidhje e kontratës së dëmshme, Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit, përvetësim gjatë

ushtrimit të detyrës zyrtare, marrja e ryshfetiit , nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore dhe falsifikim i dokumentacionit zyrtar .

Karakteristikë e rasteve të hetuara që kanë të bëjnë me institucionet tjera (ndërmarrjet publike kryesisht) është se kemi të bëjmë me shpërdorim të detyrës zyrtare, përvetësim i pa ligjshëm i pasurisë së këtyre ndërmarrjeve (duke shitur në kundërshtim me ligjin pasurinë e ndërmarrjeve pa shpallje publike), marrje e ryshfetiit (për favorizimin e operatoreve ekonomik të caktuar), falsifikim i dokumenteve zyrtare (kryesisht të raporteve që kanë të bëjnë me vlerësimin e tenderëve) si dhe lidhje e kontratave të dëmshme (ku janë gjetur kontrata të nënshkruara me vlera të mëdha në kundërshtim me ligjin në fuqi duke eliminuar operatorët ekonomik të cilët kanë qenë më të favorshëm për ndërmarrjet publike).

Karakteristikë për rastet për të cilat janë zhvilluar hetime dhe kanë rezultuar me prova të mjaftueshme për vërtetimin e fakteve të pretenduara si dhe janë dorëzuar për procedim penal të mëtijshëm në prokurorinë publike kompetente, ku të dyshuar janë personat zyrtar të Qeverisë së Kosovës është se kryesisht kemi të bëjmë me menaxherët e këtyre institucioneve si dhe me departamentet e prokurimit në kuadër të këtyre institucioneve.

Zhvillimi i procedurave të prokurimit nga ana e këtyre departamenteve është në kundërshtim me ligjin për prokurim publik, shpesh herë nuk zbatohet fare ligji i prokurimit, falsifikimi i dokumentacioneve zyrtare (raporteve në lidhje me procedurat e prokurimit), pagesat e bëra pa përfunduar punimet ose akoma pa filluar po ashtu ajo që është me skandalozja ka të bëjë me miratimin e këtyre dokumenteve nga ana e menaxhereve të institucioneve .

Sa i përket rasteve të cilat kanë të bëjnë me veprime korruptive të dyshuara në kuadër të gjykatave, kryesisht kemi të bëjmë me raste kur kërkohet ryshfet nga qytetarët për nxjerrjen e vendimeve gjyqësore, shpesh duke shkel ligjin në fuqi dhe shumica e rasteve kanë të bëjnë me nxjerrje të vendimeve të kundërligjshme por ka raste kur janë gjetur prova me të cilat është dëshmuar se janë falsifikuar dokumentet zyrtare (vendimet) e gjykatave duke mos u evidentuar në listën përkatëse, duke mos i protokolluar si dhe të njëjtat iu janë dorëzuar palëve.

Rastet e proceduara në lidhje me dyshimet për veprime korruptive të prokurorive të Republikës së Kosovës kanë të bëjnë kryesisht me shpërdorim të detyrës zyrtare pra mos zbatim të ligjit për të cilën të njëjtat janë kompetent.

ii. Pasqyra e përgjithshme e rasteve në AKK për vitin 2008

Numri i rasteve të paraqitura, rasteve të mbyllura, rasteve të proceduara në prokurorinë publike kompetente dhe organet policore dhe rasteve të mbyllura në mënyrë tabelare duken si më poshtë:

Nr.	INSTITUCIONI	Informatat e Pranuara	Rastet e mbyllura në munges provash	Rastet e përciellura në Prokurorit perkatese	Rastet në Procedurë (duke u hetuar nga AKK)
1	QEVERIA	37	15	16	06
2	PARLAMENTI	2	01	/	01
3	GJYKATAT	33	21	11	01
4	PROKURORITË	05	01	02	02
5	INSTITUCIONET TJERA.	43	23	13	07
6	PUSHTETI LOKAL	26	10	11	05
7	TOTALI	146	71	53	22

Tabela.4. Pasqyrë e përgjithshme e rasteve të paraqitura në Agjensionin Kosovar kundër Korrupsionit gjatë periudhës Janar 2008 – Dhjetor 2008

¹ Nga numri totali 16 raste janë bartur nga viti 2007

Rastet e proceduara në Prokurorit përkatëse sipas viteve ku është kryer veprimi i dyshuar korruptiv

Rastet e hetuara nga Agjensioni për të cilat janë gjetur prova për vërtetimin e fakteve për veprime korruptive dhe të cilat janë dorëzuar për procedim penal të mëtejshëm kanë ndodhë kryesisht katër vitet e kaluara duke filluar nga vitit

2005 ku në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura veprimet penale sipas viteve kur kanë ndodhë veprimet korruptive të dyshuara dhe institucionet konkrete nga ato të kategorizuara .

Nr	Institucioni	Lloji i veprës se dyshuar	Viti kur ka ndodh veprimi
1	Gjykatat	Falsifikim i dokumentacionit zyrtar	2007
2	Qeveria	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit	2007
3	Qeveria	Marrje e ryshfetit	2008
4	Ndërmarrjet Publike	Marrje e ryshfetit	2008
5	Ndërmarrjet Publike	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit	2008
6	Qeveria	Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit	2007
7	Qeveria	Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit	2007
8	Gjykatat	Nxjerrja e kundërligjshme e vendmive gjyqesore	2007
9	Qeveria	Përvetësim gjate ushtrimit te detyrës zyrtare	2005
10	Qeveria	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit	2007
11	Ndërmarrjet Publike	Përvetësim gjate ushtrimit te detyrës zyrtare	2005
12	Qeveria	Marrje e ryshfetit	2005
13	Gjykatat	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit	2006
14	Pushteti Lokal	Përvetësim gjate ushtrimit te detyrës zyrtare	2005
15	Pushteti Lokal	Përvetësim gjate ushtrimit te detyrës zyrtare	2007
16	Pushteti Lokal	Përvetësim gjate ushtrimit te detyrës zyrtare	2005
17	Ndërmarrjet Publike	Përvetësim gjate ushtrimit te detyrës zyrtare	2006
18	Gjykatat	Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit	2006
19	Gjykatat	Falsifikim i dokumentacionit zyrtar	2005
20	Qeveria	Përvetësim gjate ushtrimit te detyrës zyrtare	2007
21	Gjykatat	Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqesore	2007
22	Qeveria	Përvetësim gjate ushtrimit te detyrës zyrtare	2007
23	Gjykatat	Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqesore	2005
24	Ndërmarrjet Publike	Përvetësim gjate ushtrimit te detyrës zyrtare	2005
25	Pushteti Lokal	Falsifikim i dokumentacionit zyrtar	2007
26	Ndërmarrjet Publike	Lidhje e kontratës së dëmshme	2007
27	Qeveria	Falsifikim i dokumentacionit zyrtar	2006
28	Qeveria	Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit	2008
29	Qeveria	Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit	2006
30	Qeveria	Përvetësim gjate ushtrimit te detyrës zyrtare	2006
31	Qeveria	Falsifikim i dokumentacionit zyrtar	2008
32	Gjykatat	Falsifikim i dokumentacionit zyrtar	2008
33	Pushteti Lokal	Falsifikim i dokumentacionit zyrtar	2008
34	Ndërmarrjet Publike	Përvetësim gjate ushtrimit te detyrës zyrtare	2005
35	Gjykatat	Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit	2006
36	Qeveria	Falsifikim i dokumentacionit zyrtar	2007
37	Pushteti Lokal	Përvetësim gjate ushtrimit te detyrës zyrtare	2006
38	Ndërmarrjet Publike	Përvetësim gjate ushtrimit te detyrës zyrtare	2005
39	Prokuroria	Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit	2007
40	Ndërmarrjet Publike	Përvetësim gjate ushtrimit te detyrës zyrtare	2005
41	Prokuroria	Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit	2008
42	Pushteti Lokal	Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit	2007

43	Gjykatat	Falsifikim i dokumentacionit zyrtar	2006
44	Pushteti Lokal	Falsifikim i dokumentacionit zyrtar	2005
45	Ndërmarrjet Publike	Marrje e rryshfetit	2007
46	Qeveria	Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit	2007
47	Ndërmarrjet Publike	Lidhje e kontratës së dëmshme	2008
48	Pushteti Lokal	Përvetësim gjate ushtrimit të detyrës zyrtare	2006
49	Ndërmarrjet Publike	Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit)	2008
50	Ndërmarrjet Publike	Marrje e rryshfetit	2007
51	Gjykatat	Vendim i kundërligjshëm	2006
52	Pushteti Lokal	Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit	2007
53	Pushteti Lokal	Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit)	2006

Tabela 5. Rastet e përciellura ne prokurori sipas institucioneve konkrete dhe viteve kur kanë ndodhe veprimet korruptive

Numri i rasteve që janë paraqitur në AKK sipas viteve, në formë tabelare duket kështu

Viti i realizimit të veprimeve	2005	2006	2007	2008
Numri i rasteve	12	12	19	10

Tabela 6: Tregon totalin e rasteve te trajtura gjate vitit 2008 (sipas viteve se kur kane ndodhur veprimet korruptive)

Rastet e mbyllura

Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit nga totali i rasteve të evidentuara si të paraqitura nga qytetarët si dhe ato të hetuara sipas detyrës zyrtare pasi janë shqyrtuar paraprakisht, janë zhvilluar hetime në lidhje me rastet përkatëse dhe janë mbyllur 71 raste të paraqitura për shkak se në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, Agjensioni nuk ka pas kompetencën për hetimin e rasteve të përmendura si dhe pas zhvillimit të hetimeve në lidhje me këto raste nuk janë gjetur prova më të cilat do të provoheshim pretendimet për veprime korruptive të personave zyrtar.

Rastet në procedurë

Dhe në fund, për 22 rastet e mbetura në Agjensionin Kosovar kundër Korrupsionit janë zhvilluar procedurat hetimore dhe varësisht prej rezultatit të hetimeve rastet do të përcjellën për procedim të mëtejshëm penal apo do të merret vendimi për mbylljen eventuale të rasteve të hetuara.

Rastet anonime të paraqitura në AKK

Në kuptim të nenit 16.2 të Ligjit Kundër Korrupsionit që i referohet personave te cilët me mirëbesim kanë zbuluar informacionin për ekzistencën e korrupsionit dhe me qëllim të pengimit të pasojave të dëmshme ndaj tyre, Agjensioni ka bërë të mundur për qytetarët paraqitjen e rasteve të dyshuara të korrupsionit në mënyre anonime ku:

- numri i përgjithshëm i informacioneve anonime që ka pranuar Agjensioni është 29 raste,
- numri i rasteve anonime të proceduara në prokurorinë publike kompetente është 12 raste.

Informatat e përcjellura sipas institucionit kompetent

Nr	Vendi	Lëndët e përcjella	Arrestime	Hetime	Aktakuza	Lëndë të Hedhura	Pa informata kthyesë
1	Prokuroria e Kosovës	2	/	/	/	/	2
2	Kryeprokurori i EULEX-it	2	/	2	/	/	/
3	Prishtinë	37	2	3	1	2(gjyq)	29
4	Pejë	6	/	1	2	2(gjyq)	1
5	Prizren	6	/	1	/	4 (gjyq)	1
6	Gjilan	3	/	/	/	1(P.L)	02
7	Mitrovicë	4	/	/	/	1(gjyq)	03
8	P. Speciale	24	/	5	/	2(gjyq)	17
9	Policia e Kosovës ²	14	1	/	1	/	12
10	Policia e UNMIK-ut	2	/	/	/	/	02
11	Gjithsej	100	3	12	4	12	69

Tabela 7: Pasqyra e Informatave të dorëzuara në Prokurori qe nga funksionalizimi i AKK-së. (12.02 2007)

Gjendja e tanishme në lidhje me rastet e hetuara dhe të proceduara

Gjendja aktuale në lidhje me rastet e paraqitura si dhe ato të hetuara sipas detyrës zyrtarë është si vijon : Deri me tani numri i përgjithshëm i rasteve të evidentuar në Agjensionin Kosovar kundër Korrupsionit është 270 raste të dyshuara për veprime korruptive, pas hetimeve të zhvilluara në lidhje me rastet në fjale janë përcjellë në prokuroritë publike kompetente 100 raste, ndërsa pas hetimeve të zhvilluara ku nuk janë gjetur prova për vërtetimin e pretendimeve për veprime korruptive janë mbyllur 148 raste, 22 raste janë në procedurë dhe pas hetimeve të zhvilluara, varësisht prej rezulttit të hetimeve do të merret vendimi në lidhje me këto raste.

Ofrimi i këshillave ligjore për qytetarët

Departamenti i Hetimeve ka ofruar edhe këshilla të konsiderueshme ligjore për qytetarët e ndryshëm të cilët i janë drejtuar Agjensionit për paraqitjen e ankesave të tyre. Në këto raste Departamenti i Hetimeve duke mos qenë kompetent që vetë ti zgjidh këto raste, u ka dhënë qytetarëve këshilla ligjore dhe udhëzime për adresimin e ankesave të tyre tek institucionet kompetente.

PARANDALIMI I KORRUPSIONIT

Bazuar në mandatin që ka me Ligjin Kundër Korrupsionit (LKK), Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ne Ushtrimin e Funksionit Publik si dhe rregullave të brendshme procedurale të AKK-së, në periudhën janar-dhjetor 2008 që është lëndë e këtij raporti, Departamenti i Parandalimit ka zhvilluar një aktivitet të ngjeshur me qëllim të realizimit të obligimeve të veta që janë njëkohësisht edhe aktivitete kryesore të Departamentit e që dalin edhe nga aktet ligjore të theksuara me lartë.

Detyrat kryesore të këtij departamenti janë të fokusuar në: Mbikëqyrjen e Pasurive të zyrtarëve të lartë publik në mbikëqyrjen e Pranimit të Dhuratave dhe parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe se puna e këtij departamenti është e orientuar në parandalimin e korrupsionit.

² Rastet të cilat janë hetuar në bashkëpunim me Policinë e Kosovës

Për ndryshim nga viti 2007-të, në vitin 2008-të kemi arritur që ta kompletojmë numrin e zyrtareve të domosdoshëm, ashtu siç ka qenë e paraparë me organogramin e Agjensionit. Kjo ka rezultuar edhe me rritjen e aktiviteteve dhe punëve të kryera e në të cilat janë përfshirë të gjithë zyrtaret e Departamentit.

Për përmbushjen më të lehtë të obligimeve që dalin nga aktet ligjore dhe nënligjore, puna në Departament është e shpërndarë midis Divizionit për Mbikëqyrjen e Pasurive, Pranimit të Dhuratave dhe Divizionit për Parandalimin e Konfliktit të Interesave.

i. Mbikëqyrja e Pasurive

Duke u bazuar në nenin 39 të LKK-së, Agjensioni mbikëqyr pasurinë e personave zyrtar të lartë në bazë të informacionit të dorëzuar nga personi zyrtar i lartë në një formular të posaçëm, i cili është përcaktuar nga Agjensioni.

Sipas dispozitave ligjore të LKK-së, formularët e plotësuar duhet të dorëzohen pranë Agjensionit, deri më 31 mars, për vitin paraprak. Deri me këtë datë në vitin 2008, këtij obligimi ligjor ju kanë përgjigjur 560 apo 74.9% e zyrtarëve të lartë publik nga 747 sosh, që kanë qenë të obliguar për deklarim të pasurisë sipas LKK-së.

Në pajtim me nenin 43.1 të LKK-së, nëse zyrtari i lartë nuk dorëzon informacionin e referuar në nenin 41 dhe 42 të LKK-së, brenda afateve të përcaktuara në këtë Ligj, Agjensioni nxjerr një paralajmërim dhe vendos një afat të ri i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë nga dita e nxjerrjes së paralajmërimit.

Bazuar në këtë, Departamenti pas verifikimit të listave të zyrtarëve të cilët nuk kishin dorëzuar formularët, me datë 03 prill 2008, nxori një paralajmërim dhe vendosi një afat të ri për dorëzimin e formularëve. Afati i ri i vendosur nga AKK përcaktonte datën 25 prill 2008, si afati i fundit ligjor për dorëzimin e formularëve të deklarimeve, ku numri i zyrtarëve të lartë që kanë deklaruar pasurinë deri me këtë datë arrinte në 695 apo 93.0 %, në ndërkohë ka vazhduar të vijë formularët edhe pas kësaj date.

Në rastet kur zyrtari i lartë nuk ka dorëzuar informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar në ligj, Agjensioni ka informuar organin ku zyrtari i lartë ushtron detyrën e tij,

dhe në pajtim me nenin 43.3 të LKK-së është kërkuar që paga ose shpërblimi i pagës të

zvogëlohet me 1/5 për çdo muaj, derisa në Agjensionin Kosovar Kundër Korrupsionit të merret njoftimi se zyrtari i lartë ka dorëzuar informacionin e kërkuar. Numri i zyrtarëve të lartë, ndaj të cilëve është kërkuar që të merret kjo masë ndëshkuese ka qenë 31.

Me 31 korrik kanë përfunduar të gjitha afatet për të deklaruar pasurinë nga ana e zyrtarëve të lartë, ku nga 747 zyrtar të lartë, 17 prej tyre nuk e kanë deklaruar pasurinë dhe se Agjensioni konform nenit 43.4 të LKK-së, ka njoftuar organin ku zyrtarët punojnë, që të fillojnë procedurat e shkarkimit për mos përmbushje të obligimit ligjor.

Në të njëjtën datë të procedimit të kërkesës, 3 nga 17 zyrtarë ndaj të cilëve kemi kërkuar të ndërmerren masat administrative nga institucionet e tyre, kanë deklaruar pasurinë e tyre, dhe se numri i atyre që nuk e kanë deklaruar pasurinë në total është 14.

Lidhur me gjendjen e përgjithshme të procesit të deklarimeve të pasurisë, kemi Tabelën A, ku jepen në mënyrë të detajuar përqindjet e zyrtareve të lartë që kanë deklaruar pasurinë, të ndarë në bazë të institucioneve.

Nr	Institucionet	Numri i zyrtareve të lartë të obliguar për deklarimin e pasurisë	Numri i zyrtareve të lartë që kanë deklaruar pasurinë	Numri i zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë	Përqindja e deklarimit (%)
1	Kuvendi	123	120	3	97.50%
2	Presidenca	3	3	0	100%
3	Qeveria	226	226	0	100%
4	Gjykatat	307	297	10	96.70%
5	Prokuroria	88	87	1	98.80%
6	Totali	747	733	14	98.10%

Tabela 8: Pasqyrë e përgjithshme mbi deklarimin e pasurisë deri në fund të vitit 2008

Në vijim paraqesim emrat e zyrtarëve të lartë ndaj të cilëve Agjensioni ka propozuar institucionit, ku këta zyrtar ushtrojnë funksionin e tyre, për fillimin e procedurave për shkarkim.

1. *Lubisha Zhiviç – Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës*
2. *Sabit Rrahmani – Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës*
3. *Vezira Emrush – Deputete i Kuvendit të Republikës së Kosovës*
4. *Vlastimir Dimiç – Gjyqtare në Gjykatën e Qarkut –Gjilan*
5. *Miodrag Paviç – Gjyqtar në Gjykatën e Qarkut –Gjilan*
6. *Tomislav Petroviç – Gjyqtar në Gjykatën e Qarkut- Mitrovicë*
7. *Jelena Krivokapiç – Gjyqtar në Gjykatën e Qarkut- Mitrovicë*
8. *Zlatica Vukasinoviç – Kryetare e Gjykatës Komunale- Leposaviq*
9. *Snezhana Kostić – Gjyqtare e Gjykatës Komunale- Leposaviq*
10. *Zoran Paviç – Gjyqtar në Gjykatën Komunale –Leposaviq*
11. *Tatjana Virijeviç – Kryetare e Gjykatës për Kundërvajtje- Leposaviq*
12. *Ruzhica Simiç – Kryetar e Gjykatës Komunale -Zubin Potok*
13. *Radmila Kapetanoviç – Kryetare e Gjykatës për Kundërvajtje -Zubin Potok*
14. *Slobodan Stevanoviç – Prokuror i Prokurorisë Publike-Gjilan*

Në ndërkohë pas përfundimit të procesit të rregullt të deklarimit të pasurisë nga ana e zyrtareve të lartë që i kemi pas të regjistruar në data-bazën e Agjensionit për vitin 2008, në bashkëpunim me pikat kontaktuese nëpër institucione, kemi evidentuar ndryshime të 43 zyrtareve të lartë, ku konform LKK-së kemi kërkuar që ta bëjnë deklarimin e pasurisë së tyre me marrjen e detyrës, nga këta zyrtar, 32 zyrtar të lartë e kanë deklaruar pasurinë ndërsa 11 të tjerë janë në proces e sipër të deklarimit.

Gjithashtu, në bazë të detyrimit ligjor që Agjensioni duhet t'ia paraqesë Këshillit të Agjensionit pasuritë e personave zyrtarë që punojnë në Agjension, pasi ai është organi i cili i mbikëqyr këtë të fundit, gjatë muajve maj-qershor, Departamenti ka përmbyllur edhe procesin e deklarimit nga ana e të punësuarve në AKK, përkatësisht janë paraqitur deklarimet e 21 zyrtareve para Këshillit të Agjensionit. Zyrtarët e rinj të cilët lidhin kontratë me Agjensionin Kosovar kundër Korrupsionit janë të obliguar të deklarojnë e pasurinë e tyre .

Në kontekstin e mirë të menaxhimit të Departamentit në përgjithësi dhe divizioneve të tij në veçanti, gjatë këtij vitit 2008 ka vazhduar procesi i konsolidimit të bazës elektronike të të dhënave.

ii. Kontrolli i Formularëve të Deklarimit të Pasurive

Gjatë muajit qershor zyrtaret e Departamentit të Parandalimit e kanë përfunduar edhe procesin për shqyrtimin dhe kontrollin e formularëve mbi deklarin e gjendjes së pasurisë, në kuptim të përmbushjes së rregullt të formularit, të plotësimit adekuat dhe në bazë të kërkesave që dalin nga formulari.

Pas kontrollit teknik/logjik të formularëve rezultojn kjo gjendje:

- 280 apo 37.4 % të formularëve ka mungesa në mënyrën e të plotësuarit.
- 216 apo 28.9 % të rasteve nuk janë deklaruar të hyrat vjetore.
- 55 apo 7.3 % të rasteve nuk është deklaruar informacioni i nevojshëm rreth pasurisë së paluajtshme, ndërsa
- 52 apo 6.9 % të rasteve ka mungesë informacioni rreth parave të gatshme, pasurisë së luajtshme dhe të dhënave të tjera ku përfshihen numri personal i deklaruesit të pasurisë, përbërja familjare etj.




Tabela 9: ofron të dhëna në formë grafike lidhur me kontrollin e formularëve

Në krahasim me vitin 2007, pas kontrollit teknik-logjik të këtij viti, kemi vërejtur rënie të plotësisht jo adekuat të formularëve, dhe atë për 12.4 %. Në këtë rënie të plotësisht jo adekuat të formularëve nga ana e zyrtareve të lartë, kanë ndikuar amandamentimi dhe plotësimi i formularit mbi deklarin e pasurisë dhe caktimi i pikave kontaktuese nëpër institucione, ku janë mbajtur trajnime dhe kontakte me të gjitha pikat kontaktuese lidhur me ndihmën që mund të ju japin zyrtareve të lartë në plotësimin e formularëve.

Agjensioni në këtë vit ka filluar edhe me kontrollin e plotë të formularëve të zyrtarëve të lartë, fillimisht ka krahasuar pasurinë në mes vitit 2007 dhe 2008 se a ka mospërputhje, ky kontroll është bërë për të gjithë zyrtarët e lartë me përjashtim të zyrtarëve të lartë që pasurinë e kanë deklaruar në vitin 2008, për herë të parë. Nga ky kontroll kemi hasur në mospërputhshmëri të formularëve në mes të vitit 2007 dhe 2008 të 3 (tre) zyrtarëve të lartë ku presim sqarime. Po ashtu, gjatë këtij kontrolli duke u mbështetur edhe në data-bazën e të dhënave nga Agjensionin për Regjistrimin e Bizneseve (ARB), i cili gjendet në kuadër të Mistrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), kemi konstatuar se 37 (tridhjetë e shtatë) zyrtarë të lartë posedojnë biznese të regjistruara, 27 (njëzet e shtatë) prej tyre e kanë deklaruar biznesin në formularët e deklarinimit të pasurisë, ndërsa 10 (dhjetë) prej tyre nuk e kanë bërë një gjë të tillë, ku nga këta zyrtarë të lartë kemi kërkuar sqarime për mos-deklarim të bizneseve, 5 zyrtarë të lartë kanë ofruar informacione, ndërsa për 5 (pesë) të tjerë jemi në pritje të informacioneve shtesë.

Listën prej 37 zyrtarëve të lartë të cilët kanë biznese të regjistruara i kemi dorëzuar në pjesën tjetër të departamentit që ka të bëjë me Konfliktin e Interesit për shqyrtim të metutjeshëm, ngase janë dyshuar për Konflikt Interesi.

Nr	Institucionet	Numri i zyrtarëve të lartë që kanë të regjistruara biznese	Numri i zyrtarëve që e kanë deklaruar biznesin	Numri i zyrtarëve të cilët nuk e kanë deklaruar biznesin
1	Kuvendi	12	10	2
2	Presidenca	1	1	0
3	Qeveria	23	16	7
4	Gjykatat	1	0	1
5	Prokuroria	0	0	0
6	Totali	37	27	10

Tabelën 10 ofron të dhëna mbi rastet e dyshuara të konfliktit të interesit, të nxjerra gjatë kontrollit të plotë të formularëve mbi gjendjen e pasurisë

Gjatë vitit 2008, Agjensioni konkretisht Divizioni për Mbikëqyrjen e Pasurisë dhe Dhuratave ka ndërmarr të gjitha hapat e duhur në rritjen e bashkëpunimit me institucionet që kanë mision të përafërt me Agjensionin, në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, si dhe me institucionet relevante që mund të na ofrojnë të dhëna të nevojshme për konstatimin e mospërputhshmërisë së pasurisë së deklaruar nga ana e zyrtarëve të lartë dhe gjendjes reale, disa nga këto institucione kanë shprehur gatishmëri për bashkëpunim me Agjensionin, dhe bashkëpunim me te ngushtë gjatë këtij viti ka pas me Komunën e Prishtinës dhe atë të Prizrenit, ndërsa ka edhe prej atyre që nuk kanë bashkëpunuar. Por, Agjensioni Kosovar Kundër – Korrupsionit konkretisht Departamenti i Parandalimit në funksion të zbatimit e nenit 37 të LKK-së, për Mbikëqyrjen e Pasurisë së zyrtarëve të lartë, për të konstatuar se a ka mospërputhje mes pasurisë së deklaruar dhe gjendjes reale, në pajtim me nenet 15, 17 dhe 23 pika b të LKK-së, ka kërkuar që të bashkëpunon me organet relevante, që të na ofrojnë informacione të nevojshme. Duke u bazuar në nenet e lartcekura të LKK-së dhe Memorandumin Bashkëpunimi për shkëmbim informata i lidhur në mes Qendrës së Inteligjencës Financiare (QIF) dhe Agjensionit, nga QIF kemi kërkuar që të na ofron të dhëna mbi gjendjen e xhirollogarive bankare për disa zyrtarë të lartë, por një gjë e tillë është refuzuar.

Po ashtu, në kuadër të mbikëqyrjes së pasurisë të zyrtarëve të lartë, Agjensioni iu është drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme me një kërkesë për ofrimin e bazës elektronike të të dhënave të regjistrimit të automjeteve, mirëpo nuk

na kanë ofruar, me arsytim se ende nuk është e finalizuar ndërtimi i data – bazës qendrore elektronike të regjistrimit të automjeteve, por na kanë ofruar listën në formë të shkruar e cila ka qenë shumë e mangët dhe e përgjithësuar e cila nuk na ka ndihmuar në punën tonë. Nga ana tjetër kemi kontrolluar një bazë elektronike të të dhënave të automjeteve të siguruar në vitin 2007, për periudhën Maj, Qershor, Korrik të vitit 2007, ku kemi evidentuar që 10 zyrtarë të lartë kanë regjistruar automjetet e tyre në këtë kohë, prej këtyre zyrtareve të lartë, 7 e kanë deklaruar automjetet e tyre në formularin për deklarimin e pasurisë, ndërsa tre të tjerë nuk e kanë deklaruar automjetet, mirëpo kemi konstatuar se vlera e tyre ka qenë e vogël dhe nuk kanë pasur obligim ligjor për deklarim.

Ne kuadër të mbikëqyrjes së pasurisë të zyrtareve të lartë kemi kërkuar nga 13 komuna të Republikës së Kosovës, që të na japin informacione lidhur me pasuritë e paluajtshme të një pjese të zyrtareve të lartë, pasuri e cila evidentohet nga zyra e kadastrave të komunave gjegjëse, ku nga gjithsej 13 komuna, sa kemi kërkuar informacione, vetëm 4 prej tyre na kanë ofruar informacione. Komunat të cilat nuk na kanë ofruar informacione, iu kemi dërguar për herë të dytë shkresa me qëllim të ofrimit të dhënave të kërkuara, pasi që e kanë obligim ligjor konform LKK-së.

Gjate kontrollimit të formularëve për deklarimin e pasurisë dhe listave poseduese të pronës të cilat i kemi pasur në dispozicion për disa zyrtar të lartë nga komunat që kanë bashkëpunuar, kemi konstatuar se ka mospërputhje të pasurisë së deklaruar dhe gjendjes reale të 4 zyrtarëve të lartë, të cilëve iu kemi dërguar shkresa prej të cilëve 2 (dy) kanë ofruar sqarime shtesë, ndërsa 2 (dy) të tjerë nuk i janë përgjigjur shkresave që ia kemi dërguar, për zyrtaret e lartcekur të cilët nuk na kanë ofruar informacionet e kërkuara nga Agjensioni, do të informojmë institucionet ku ata ushtrojnë funksionet e tyre konform LKK-së.

Kontrolli i formularëve të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë është në proces, këtë vit janë bërë hapat e parë në këtë drejtim por kemi hasur në vështirësi për shkak të legjislacionin në fuqi që rregullon këtë fushë dhe mungesën e vullnetit për bashkëpunim të institucioneve relevante.

Miratimi i Projektligjit për Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik do të ndihmonte që ky proces të jetë me efikas.

iii. Pranimi i Dhuratave

Në pajtim me kreun e – IV-të LKK-së dhe Udhëzimit Administrativ 02/2008, që ka të bëjë me pranimin e dhuratave, gjatë këtij vitit, Departamenti i Parandalimit të Korrupsionit ka marrë masa konkrete, fillimisht ka përgatit katalogun e veçantë për dhuratave, ka përgatit udhëzimet për plotësimin e këtij katalogu si dhe ka caktuar pikat kontaktuese nëpër institucione qendrore, ndërsa është në proces të caktimit të pikave kontaktuese edhe nëpër institucionet lokale dhe agjensionet e pavarura, për koordinimin e veprimeve që dalin nga LKK-ja dhe Udhëzimi Administrative 02/2008, përkritazi me dhuratat. Në kuadër të kësaj, sipas nenit 35 të LKK-së të gjitha institucionet që janë të detyruara me ligj të mbajnë katalogët e dhuratave i dërgojnë kopjet e katalogëve për vitin paraprak në Agjension jo më vonë se dita e fundit e marsit të vitit vijues për vitin paraprak. Në vitin 2008 sipas afatit ligjor 3 (tri) nga 18 (tetëmbëdhjetë) institucione kanë sjellur katalogët e dhuratave, ndërsa të tjerët, kanë njoftuar me shkrim se zyrtaret e tyre nuk kanë pranuar asnjë dhuratë gjatë vitit paraprak.

Tri nga këto institucione janë : Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Energjisë dhe Minierave dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës.

iv. Parandalimi i konfliktit të interesit

Në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesi ne Ushtrimin e Funkcionit Publik dhe Ligjit Kundër Korrupsionit , Divizioni për parandalimin e konfliktit të interesit ka zhvilluar aktivitetet të caktuar që për qëllim ka pasur paralajmërimin e zyrtareve të lartë për shmangie nga konflikti i interesit. Këtë gjithnjë duke u bazuar në kompetencën që ja japin Agjensionit ligjet e lartpërmendura.

Në bashkëpunim me Divizionin për deklarimin dhe mbikëqyrjen e pasurisë, gjatë kontrollimit të formularëve për deklarim të pasurisë së zyrtarëve të lartë dhe nga burime të ndryshme të Agjensionit janë evidentuar gjithsej 45 raste të

konfliktit të mundshëm të interesit, ku në 19 raste u janë bërë shkresa konkrete nga Agjensioni, me të cilat është kërkuar nga zyrtarët e lartë, që të bëjnë shmangien e gjendjes së konfliktit të interesit, 7 raste i kemi ende në shqyrtim kurse 19 raste i kemi të mbyllur pas që një gjendje e tillë nuk paraqet konflikt të interesit konform LKK-së dhe Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Divizioni ka vepruar po ashtu edhe në raste ku gjendja e konfliktit të interesit ka qenë e përkohshme. Në formë tabelare këto aktivitete duken kështu.³

Nr	Institucioni	Rastet dyshuara për Konflikt Interesit	Raste që janë shmangur Konfliktit Interesit	Raste në shqyrtim	Raste të mbyllura në mungesë provash
1	Kuvendi	12	0	2	10
2	Qeveria	29	16	4	9
3	Presidenca	1	1	0	0
4	Gjykatat	1	0	1	0
5	Pushtet lokal	1	1	0	0
6	Institucione tjera	1	1	0	0
7	Totali :	45	19	7	19

Tabela 11: pasqyron rastet e konfliktit të interesit

Po ashtu, Divizioni për parandalim, ka pasur edhe një fushë të gjerë të veprimit sa i përket parandalimit të keqpërdorimeve dhe mos zbatimit të rregullt të procedurave të tenderimit. Departamenti i Parandalimit për çdo rast që ka pasur informacion, apo edhe ex-officio, ku ka vërejtur se ka shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik nëpër institucionet e Republikës së Kosovës ka intervenuar duke penguar që të ketë favorizime apo diskriminime të operatoreve ekonomik, apo në mes të vet operatoreve ekonomik si edhe në mes operatoreve ekonomik dhe autoritetit kontraktues.

Si zyrtarë të Departamentit për parandalim kemi marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesit gjatë zhvillimit të procedurave të disa tenderëve, dhe në raste të caktuara kemi vërejtur favorizime të operatoreve ekonomik, apo mosrespektim të dispozitave ligjore, dhe si divizion kemi dhënë rekomandime për autoritetet kontraktuese, ku të njëjtit pastaj kanë vepruar në pajtueshmëri me rekomandimet tona të bazuara në ligj. Vlen të theksohet se ky vit karakterizohet me rritje të bashkëpunimit mes institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit, me funksion të rritjes së transparencës kemi pranuar ftesë zyrtare nga Universitetin i Prishtinës dhe Korporata Energjetike e Kosovës të vëzhgojmë në procedurat e prokurimit, që këto dy Institucione i zhvillojnë.

³ Gjendje e përkohshme e konfliktit të interesit nënkupton angazhimin e anëtarëve në komisione përzgjedhëse, që kanë mandat të shkurtër

N r	Institucionet	Raste të paraqitura	Raste të parandaluara	Raste në shqyrtim	Raste për Dep. e hetimeve	Raste të mbyllura ⁴	Vlera e parandaluar në Euro
1	Qeveria	9	3	1	4	1	3.000.000
2	Pushteti Lokal	4	0	2	2	0	100.000
3	Policia e Kosovës	1	1	0	0	0	---
4	Te tjera	6	1	2	0	3	500.000
5	Totali	20	5	5	6	4	3.600.000

Tabela 12: pasqyron rastet e paraqitura dhe të parandaluara të korrupsionit sidomos në fushën e tenderëve

Vlera e parandaluar e paralogaritur në shifra për vitin 2008 kap shumën e mbi 3.600.000 €uro. Gjithashtu departamenti i parandalimit të korrupsionit, bazuar në informatat që ka pranuar nga burime të sigurta, ka vepruar edhe në situata kur punimet të ndryshme kanë përfunduar, ndërsa autoritetet kontraktuese, të njëjtat figurojnë në planifikimin e prokurimit për vitin 2008, këtë dukuri e kemi hasur në dy komuna të republikës së Kosovës dhe në një nga Ministrinë e Qeverisë së Kosovës.

Te këto raste ne kemi verifikuar gjendjen reale në teren dhe pastaj kemi nxjerr opinione dhe rekomandime konform ligjit me qëllim të evitimit të këtyre shkeljeve.

Janë trajtuar edhe lëndë të cilat janë dyshuar për elemente të korrupsionit, por meqenëse të to efekti ka ndodhur, dhe mundësia e parandalimit ka qenë e pamundur, departamenti i parandalimit të korrupsionit, si të tilla, i ka bartur tek Departamenti i Hetimeve për procedurë të mëtejshme.

EDUKIMI I PUBLIKUT

Me qëllim të sensibilizimit të opinionit të gjerë, qytetarëve dhe institucioneve publike si atyre të nivelit qendror edhe atij lokal, Agjensioni gjatë periudhës Mars – Prill 2008 me ndihmën dhe përkrahjen e UNDP dhe OSCE ka organizuar fushatën kundër korrupsionit.

Në fushatën kundër korrupsionit „ Korrupsioni mbaron më ju “ si institucione ku do të zhvillohet fushata janë përzgjedhur institucionet qendrore dhe ato lokale, nga institucionet qendrore janë përfshirë 13 ministri, ndërsa nga ato lokale janë përfshirë 15 Kuvende Komunale në nivel vendi.

Është prezantuar edhe në 6 debate publike të organizuara nëpër komunat e Kosovës me qëllim sensibilizimin e shërbyesve civil kundër korrupsionit.

Fushata është konceptuar në atë mënyrë që janë mbajtur ligjërata me zyrtaret e këtyre institucioneve në të gjitha nivelet, posaçërisht zyrtaret kompetent të zyrave për marrëdhënie me publik, ku pas ligjëratave të mbajtura në lidhje me njoftimin e rolit të AKK-së, kompetencat, mënyrën e bashkëpunimit, mënyrën e raportimit të rasteve të dyshuara të korrupsionit në fund është bërë shpërndarja e materialit të fushatës së bashku me një broshurë me të dhënat për punën e Agjensionit.

Agjensioni Kosovar Kundër Korrupsionit vazhdimisht ka kultivuar frymën e bashkëpunimit me qytetarë në luftën dhe parandalimin e korrupsionit. në këtë kontekstë, AKK në bashkëpunim me misionin në Kosovë të Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë OSBE, më 27 tetor 2008 fillojë ciklin e parë të fushatës sensibilizuese kundër korrupsionit të titulluar “ Përpjekjet e përbashkëta për luftimin dhe parandalimin e Korrupsionit në Kosovë”.

⁴ Raste të mbyllura janë rastet që gjatë shqyrtimit nuk është konstatuar ndonjë element i korrupsionit

Kjo fushatë fillojë në Prizren për të vazhduar më pastaj në qytetin e Therandës/Suharekë, Gjilanin, Vitin, Pejën dhe Klinën, ndrysa në vitin 2009 do të vazhdojë dhe do ti përfshijë gjitha komunat e Kosovës.

Fokus grup I kësaj fushate ishin shërbyesit civil të komunave por edhe persona tjerë që direk apo indirect menaxhojnë me paran publike (përfaqësuesit e kompanive publike, spitaleve sikurse edhe përfaqësues të medias dhe shoqërisë civile). Këto aktivitete ishin të dizajnuar në formë të debateve, ndërsa një numër I madhë njerëzish të këtyre insitucioneve patën rastin që drejtë për së drejti të njoftohen nga zyrtarët e Agjensionit për mënyrat e funksionimit të AKK-së, sidhe mundësit për forcimin e bashkëpunimit. Cikli i parë I kësaj fushate përfundojë në fundë të dhejtorit 2008, ndërsa do të vazhdojë në shkurtë të vitit 2009 dhe do ti përfshijë të gjitha komunat e Kosovës.

Paralelishtë me fushatën e lartë përmendur Agjensioni mbajti edhe pesë debate tjera me qytetar në Prishtinë, të cilat u mbështetën nga zyra në Kosovë e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara UNDP - Programi Iniciativa Kosovare për Transparenc KTI. Të konceptuara në formë të forumeve, zyrtarët e AKK-së u ofruan edhe fizikisht me shtresa të ndryshme qytetarësh, si me studentët nxënës, zyrtarë të partive politike, mjek dhe punëtorë tjerë shëndetësor, njerëz nga shoqëria civile dhe gazetarët për t'iu dhënë atyre mundësin e njohëjes me punën dhe aktivitetet e AKK-së, sidhe u shtruan për diskutim çështje shqetësuese të praktikave dyshuese për korrupsion.

Poashtu gjatë këtyre debateve me motive ndërgjegjësuere zyrtarët e AKK-së u bënë thirrje këtyre kategorive qytetarësh për mobilizim të përbashkët dhe për të treguar vullnetin qytetar drejtë e ngritjes së frymës së bashkëpunimit mes AKK-së dhe qytetarëve. Të gjitha debatet që janë mbajtur me këto kategori njerëzish kanë qenë shumë të frytëshme dhe nga to janë nxjerr shumë konkluzione, që krysishtë adresohen nevojat për fuqizimin e ligjit si në fushën e arsimit parauniversitar dhe universitar, segmentin e llogaridhënjes për partit politike, për shëndetësisn, shoqërin civile dhe mediat.

Agjensioni në bashkëpunim më UNDP-në dhe Asociacionin e Gazetarëve Profesionist të Kosovës (AGPK), më 9 dhjetor 2008 ka organizuar ditën ndërkombëtare të luftës kundër korrupsionit dhe janë dhënë çmimet e vitit për gazetari hulumtuese në fushën anti-korrupsionit, të ndarë në tre kategori: storia më e mirë televizive, storia më e mirë në mediat e shkruara, dhe storia më e mirë në radio.

LEGJISLACIONI/HARMONIZIMI I TIJ

Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit gjatë periudhës kohore të raportimit ka dhënë një kontribut të çmuar në harmonizimin dhe forcimin e kuadrit ligjor Kundër Korrupsionit, sikurse edhe në segmente tjera që kanë lidhje indirekte me këtë fushë.

Agjencioni Kosovar Kundër Korrupsionit në mënyrë aktive u angazhua në lidhje me Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Kundër Korrupsionit, Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik dhe përgatitjen e projektligjit për Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë të cilat tashmë janë në procedurë të shqyrtimit dhe aprovimit nga institucioni përkatës kompetente.

AKK-së ka dhanë kontributin e vetë, përmes komenteve profesionale në lidhje me harmonizimin e ligjeve bazike të punës së AKK-së me ligjet e Pakos së Presidentit Ahtisari, të njëjtat i janë dërguar grupit përkatës për shqyrtimin dhe inkomporimin e tyre.

Zyrtarët e AKK-së në mënyrë aktive ishin pjesëmarrës në takimin e nëngrupit qeveritar për anti-korrupsion në kuadër të reformës së administratës publike në Kosovës të organizuar nga Ministria e Shërbime Publike.

Poashtu, AKK ka dhënë kontributin profesional edhe në përgatitja e planit për implementimin e Partneritetit Evropian nga Agjencioni Kosovar kundër Korrupsionit

Me qëllim të implementimit të mandatit ligjor dhe funksionalizimit më të madh të Agjencionit, zyrtarët e departamenteve të AKK-së gjatë periudhës raportuese kanë zhvilluar një aktivitet të rëndësishëm në drejtim të përgatitjes së akteve të brendshme, ku në këtë aspekt janë përgatitur 23 Propozim – Vendime për nënshkrim nga ana e Drejtorit të AKK-së.

STRATEGJIA KUNDËR KORRUPSIONIT DHE PLANI I VEPRIMIT

- Ligji Kundër Korrupsionit e obligonë Agjencionin kosovarë Kundër Korrupsionit që të përpilojë strategjinë kombëtare kundër korrupsionit, si dhe planin e veprimit si dokumentë me masa konkrete kundër korrupsionit.
- Në vijim të procesit të konsultimeve dhe diskutimeve paraprake të mbajtura nga grupi i brendshëm punues i AKK-së gjatë tre mujorit të parë të vitit 2008 në qershor të 2008 AKK iniciojë përgaditjen e strategjisë së re kundër korrupsionit dhe thirri mbledhjen e parë të grupit punues ndër-insitucional, ku u ftuan të marrin pjesë të gjitha institucionet përgjegjëse.
- Duke marr parasysh nevojën për transparencë dhe në mënyrë që të sigurohej një pjesëmarrje sa më e gjërë, në proces u përfshinë shumë institucione: - zyra e kryeministrit, përmes zyrës për qeverisje të Mirë, përfaqësues nga shumica e ministrive, nga institucionet e pavarura nga shoqëria civile, mediat si dhe ekspertë ndërkombëtar. Procesi i përpilimit të strategjisë fillojë në muajn prill 2008. Grupi punues mbajti pesë takime në Prishtinë, dokumenti i projekt strategjisë u finalizua gjatë një punëtorie që u mbajtë më datë 30 dhe 31 korrik 2008 në Ohër të Maqedonisë.
- Strategjia Kombëtare Kundër Korrupsionit është dokument bazë i politikave-kundër korrupsionit të shtetit të Kosovës, dhe si i tillë paraqet objektivin kryesorë të vendit për parandalimin dhe luftimin e Korrupsionit në një afat kohor - për një periudhë tre vjeçare, - 2009 -2011.
- Strategjia identifikon dhe parashtron sektorët prioritar ku duhet të përqëndrohet lufta kundër korrupsionit si dhe objektivat specifik të luftës kundër korrupsionit që duhet të zbatohet çdo insitucion i përfshirë në kategorin e sektorëve prioritar.
- Strategjia ka natyrë gjithë përfshirëse, shtrihet në sektorin publik dhe në atë privat si dhe sheh publikun në përgjithësi, shoqërin civile dhe median në veçanti si faktor kyç në transparencën e kryerjes së zbatimit të strategjisë.
- AKK dokumentin final të strategjisë kombëtare Kundër Korrupsionit e dërgojë në Qeveri në shtator të vitit 2008, dhe ajo pritet të procedohet në Kuvendin e Kosovës për tu miratuar.
- Objektivi i përgjithshëm i strategjisë dhe ata specifik sipas sektorëve prioritar më pas prezantohen me masa konkrete specifike dhe të prekshme në planin e Veprimit Kundër Korrupsionit i cili ka filluar të përpilohet në dhjetor të vitit 2008, dhe pritet të përfundojë në maj të vitit 2009.

ADMINISTRATA/BUXHETI

Gjatë vitit 2008 Departamentin e Administratës nuk e ka përciell ndonjë përoblem substancial. Problemet e buxhetit apo edhe shqetësimet tjera teknike që e përcollën këtë departament gjatë vitit 2007 u tejkaluan dhe puna ka rrjedhur pa ndonjë problem të madhë.

Kompletimi i stafit që ndodhi gjatë këtij viti ka ngritur jashtëzakonishtë cilësin e këtij departamenti, por edhe gjithë punën e Agjencionit si insitucion.

Ky departament është i ndarë në dy divizione dhe tani rrjedhimishtë do të prezntohet puna e tyre, sikurse edhe puna e zyrës së Prokurimit.

Dvizioni i shërbimeve të përgjithëshme ka kryer punë të rregullta administrative si, përgaditjen, protokolimin dhe dorëzimin e të gjitha shkresave zyrtare, përgaditjen dhe dorëzimin e pasqyrave financiare të vitit 2008, Përgaditjen dhe planifikimin e buxhetit, sipas kategorive ekonomike për vitin 2009-2011 (BDMS), Përgaditja e PIP-it , për projektet kapitale, Planin e rrjedhës së parasë , mirëmbajtja dhe servisimi i rregullt i automjeteve , gjeneratorit , pajisjeve të IT , objektit dhe punë tjera si dhe përgatitjen dhe procesimin e rregullt të pagesave të t'gjitha shpenzimeve të AKK-së.

i. Buxheti për vitin 2008

Siq është thënë edhe më lartë për vitin 2008 buxheti ishte alokuar ashtu siq AKK ka këkuar për këtë vit, me nevojat e saj duke marr parasyshë edhe envojën e pasjes së stafit të plotë prej 35 zyrtarëve.

Buxheti i lejuar për AKK-në për vitin 2008 në kategoritë ekonomike nga Kuvendi i Kosovës duket kështu:

• Pagat dhe mëditjet	147,151.00 €
• Mallra dhe Shërbime	244,649.00 €
• Shpenzimet Komunale	24,800.00 €
• Shpenzimet Kapitale	40,000.00 €
Gjithsej:	456.600.00 €

TABELA E SHPENZIMEVE NË KATEGORITË EKONOMIKE – 2008

Nr	PERSHKRIMI	Buxheti	Shpenzim et	Zotuara	Shpenzimet +Zotuara (4 +5)	% shpenzim eve (4/3*100)	% shpenzimev e dhe zotimeve 6/3*100
1	Pagat dhe meditjet	147,151.00	97,701.25	0	97,701.25	66.4	66.4
2	Mallra dhe shërbime	244,649.00	192,681.72	22,253.69	214,935.41	78.76	87.85
3	Shpenzimet komunalive	24,800.00	7,622.86	1,549.86	9,172.72	30.74	36.99
4	Shpenzimet kapitaleve	40,000.00	33,539.72	0	33,539.72	83.85	83.85
	Gjithsejt	456,600.00	331,545.5	23,803.55	355,349.10	72.61	77.83

Në tabelën 13: po shihet mos realizimi i buxhetit në kufijtë e planifikuar të rrjedhës së parasë në Paga dhe Mëditje dhe Mallra e Shërbime i cili është rezultat i asaj se deri në muajin mars 2008 nuk është lejuar pranimi i 20 punëtorëve të rinjë. Ky proces ishte është në vazhdimësi dhe afër realizimit të plotë.

Paraqitja grafike e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike




Tabela 14: paqyron shpenzimet sipas kategorive ekonomike

ii. Zyra e Prokurimit

Zyra e Prokurimeve në organizimin e brendshëm të Agjencionit nuk është nën përgjegjësinë e Departamentit të Shërbimeve Administrative, por si zyrë e veçantë, megjithatë për efekt të këtij raporti dhe meqenëse detyrat e kësaj zyre lidhen ngushtësisht me shërbimet, aktivitetet e saj po i paraqesim si nënseksion i Departamentit të Shërbimeve Administrative.

Gjatë vitit 2008, detyrat e zyrës së prokurimeve kanë qenë të fokusuar në këto drejtime:

iii. Aktivitetet e zyrës së Prokurimit

Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur dhe zhvilluar këto aktivitete të prokurimit:

Furnizime : 6 aktivitete me procedurë për blerje me vlerë minimale	3,911.04 €
Shërbime : 7 aktivitete me procedurë shërbime me vlerë minimale	3,539.69 €
Furnizime : 9 aktivitete me procedurë për kuotimin e çmimeve	33,930.40 €
Shërbime : 1 aktivitet me procedurë për kuotimin e çmimeve	2,376.00 €
Furnizime : 2 aktivitete me procedurë të hapur	49,183.92 €
TOTALI I PËRGJITHSHËM	92,941.05 €

Janë zhvilluar 13 aktivitete të prokurimit procedurë për blerje dhe shërbime me vlerë minimale
 Janë zhvilluar 10 aktivitete të prokurimit furnizim dhe shërbime procedurë për kuotimin e çmimeve
 Janë zhvilluar 2 aktivitete të prokurimit furnizim me procedurë të hapur
 Dy aktivitete të prokurimit janë anuluar . Janë përgatitur lëndë për pagesë sipas kontratave afatgjate si dhe pregaditjen e dokumentacionit për pagesa të ndryshme që kanë arritur në zyre.

iv. Burimet Njerëzore/Personeli

E tërë puna është bazuar mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe procedurat e rekrutimit.

Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Përkthimit (shih Aneksin I) është pjesë e Departamentit të Shërbimeve Administrative. Megjithë disa pengesave të vogëla divizioni është fokusuar në arritjen e misionit të tij dhe ka bere një punë të kënaqshme në aspektin e trajtimit në kohë dhe me efikasitet të:

- Hapjes së vendeve të reja të punës dhe kryerjes së procedurave transparente për punësimin e zyrtarëve të rinj;
- Përgatitjes së kontratave për stafin e ri;
- Dorëzimin e formularëve për paga;
- Krijimin e një plani trajnimesh për aftësimin e zyrtarëve të Agjencionit si dhe mbajtjen e shënimeve për trajnime dhe organizimin e tyre, etj.

Me pranimin e zyrtarit për përkthim kemi pasur përkthime të rregullta dhe gjithashtu material të ndryshëm nga aktivitetet e AKK-së.

pranimin e zyrtarit për përkthim kemi pasur përkthime të rregullta dhe gjithashtu material të ndryshëm nga aktivitetet e AKK-së.

Kjo zyrë poashtu vazhdimisht është kujdesur edhe për dosjet personale për secilin nga të punësuarit me të gjitha dokumentet që posedojnë duke filluar nga aplikacioni e deri te ndonjë certifikat trajnim I cili ruhet në AKK-ë.

Tabela në Shtojcën 2, tregon me hollësi trajnimet e kryera dhe fushat përkatëse të trajnimit që ka marrë stafi i AKK-së. Duhet theksuar se trajnimet kanë qenë rezultative dhe të gjithë zyrtarët e Agjencionit janë përpjekur që eksperiencat e përfituara prej tyre ti venë në veprim. Gjithsesi nuk mohohet nevoja e trajnimeve të mëtejshme e të specializuara në fusha të ndryshme, meqenëse Agjensioni ende mbetet një institucion i ri.

ZYRA PER MARRËDHENIE ME PUBLIKUN

Gjatë periudhës së raportimit zyra për Marrëdhënie me Publikun, punën e vetë e ka të përqendruar kryesisht në këto aspekte:

- Takime me gazetarë dhe qytetarë;
- Faqja e re zyrtare e internetit;
- Deklaratat për shtyp;
- Monitorimi i mediave për periudhën janar – dhjetor 2008 dhe
- Aktivitete dhe bashkëpunimi

i. Takime me gazetarë dhe qytetarë

Gjate gjithë periudhes se funksionimit te Agjensionit ka pasur një interesim te madh si nga ana e komunitetit te gazetarëve por edhe nga ana e publikut persë i përket iniciativave dhe aktivitetëve te Agjensionit, ku nuk kane munguar dhe interesimi për te bashkëpunuar ngushtësisht për parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni ne shoqërinë kosovare.

Gazetare sikundër dhe qytetare te thjeshte gjate 1 viti kane trokitur shpesh ne deren e institucionet me qellim per te marre informacione e te dhena te detajuara se si mund ta ndihmojne Agjensionin apo bashkepunojne me te. Zyrtaret e Agjensionit kane qene gjithmonë te gatshem e iu kane ofruar asistencë te specializuar dhe bashkëpunim ne rastet kur ka pasur dyshime te bazuara per raste korruptive.

ii. Konferencat dhe komunikata per shtyp

Gjate vitit 2008 , Zyra për Marrëdhëniet me Publikun ka luajtur nje rol të rëndësishëm ne berjen publike dhe sigurimin e shpërndarjes ne te gjithe median e shkruar dhe elektronike te komunikates per shtyp mbi rezultatet e deklarimit te pasurise te zyrtareve te larte. Raporti i parë për media është bërë me datën 12 shkurt 2008 që ka të bëjë me punën një vjeqare të Agjensionit për vitin 2007.

Komunikata per shtyp e datës 29.04. 2008 ka pasur shume jehone si ne median e shkruar dhe ate vizive ne paraqitjen e gjendjes se sakte mbi deklarimet e kryera nga zyrtaret e larte neper institucionet qendrore. Poashtu Konferenca për shtyp me datën 17 qershor 2008, në ndërtesën e Agjensionit Kosovar Kundër Korrupsionit kishte interesim të madhë të mediave nga Kosova dhe Shqipëria . Brenda vitit 2008 zyrtaret e Agjensionit Kosovar kunderkorrupsionit kane marre pjese ne mbi 50 debate ne media elektronike TV dhe Radio .

Gjithashtu, Zyra per Marrëdhëniet me Publikun ne cdo moment ka qene e gatshme per tiu përgjigjur ne menyre profesionale kërkesave te ndryshme qe vijne nga gazetarë apo media mbi iniciativat ose detyrat e Agjensionit.

iii. Monitorimi i mediave ne periudhen janar - dhjetor '08

Në këtë tabelë janë përmbledhur shifrat e mediave të cilat kanë shkruar për rastet korruptive prej muajit janar-dhjetor 2008

Janar 2008

- 25 shkrime kryesisht për raste korruptive ku, gazetarët janë fokusuar në të gjitha institucionet e ndryshme publike;
- Raportet e auditimit kane qene pikat ku gazetarët shkruar . Po ashtu afera korruptive ne KEK po ashtu ministrinë janë akuzuar për korrupsion;
- Gazetarët kane shkruar shpesh ne kete muja per projekte fantome te ministrise se Bujqesise , ku dyshohet per keqpërdorime poashtu edhe per komunat e Kosoves ku jane gjetur parregullsi te medha.

Shkurt 2008

- 18 shkrime për raste korruptive nga institucionet publike; Kritikohet si prokuroria e Kosoves ui mbyll rastet per korrupsion, per individi te ndryshem qe nga AKM e deri te ndermarjet publike .
- Shumica e këtyre shkrimeve kanë të bëjnë më me dyshime për korrupsion AKM, po ashtu edhe me keqpërdorime në tenderët e komunave, ne ket muaj është shkruar edhe korrupsionin nëpër gjykata dhe prokurori dhe heshtja e tyre para dukurive te keqija
- Shkrimet tjera kanë të bëjnë me afera korruptive nëpër spitale dhe PTK.

Mars 2008

- 21 shkrime të cilat kanë paraqitur ekskluzivisht Agjensionit dhe punen e kryer prej tij;
- Eshte trajtuar ceshtja e deklarimeve te pasurive dhe nese do të përfundojë si duhet apo jo. Ne muajin mars eshte shkruar per arrestimin e Drejtorit te Aeroportit dhe zyrtares se prokurimit , dhe pronarit te Petrol Kompanise . Poashtu kanë qen te botuar edhe artikuj per keqpërdorimet ne KEK .Per korporaten Energjetike te Kosoves eshte shkruar per cdo muaj per keqpërdorime .

Prill 2008

- 11 shkrime për Agjensionin dhe veprimtarine e tij;
- Pas komunikatës nga Agjensioni për deklarimin e pasurisë, shkrimet kanë qenë të fokusuara rreth deklarimit të pasurive dhe mosdeklarimi i pasurive të ministrave dhe të gjithë zyrtarëve në detyra publike.
- Shkrimet kanë qenë kryesisht kritike ndaj qeveritarëve te cilet nuk e kanë bërë deklarimin e pasurisë së tyre.

Maj 2008

- Gjithsej 6 artikuj në gazeta;
- Shumica e shkrimeve kane qen shkrime per keqpërdorime ne PTK dhe KEK

Qershor 2008

- Gjatë këtij muaji kanë qenë 15 shkrime shkrimet kane pas te bejne me hetmet kunder gjykatësve dhe prokurorëve qe jane burgosur per ryshfet ;rasti Gjykatesve dhe prokurorëve te suspenduar muajve te fundit mediat i kane kushtuar shume gjykatave , prokurorive , per mospunen e tyre ne raste te ndryshme . Artikujt e botuar kane pas te bejen me keqpërdorimet e ministrine e tregtise ne kohen e Ministrit Bujar Dugolli . Dukuri tjera korruptive qe kane qenë të shkruara kane qene manipulimi me prona korupsioni ne shendetesi .

Korrik 2008

- 9 shkrime në muajin korrik , gazetarët janë fokusuar në të gjitha institucionet e ndryshme publike;
- Raportet e auditimit në ministrinë e arsimit në vitin 2007 poashtu edhe auditivi ne agjensionin publik te prokurimit ku gjenden një varg parregullsi . Poashtu afera korruptive ne aeroport po ashtu ministrinë janë akuzuar për korupsion;Poashtu edhe aferat korruptive ne KEK
- Gazetarët kane shkruar për komunat e Kosoves ku jane gjetur parregullsi te medha poashtu edhe rasti i ish drejtor në komunën e Prishtinës .

Gusht 2008

- 19 shkrime për raste korruptive nga institucionet publike;duke filuar nga prokuroria dhe gjyqësia e Kosoves ku mbyll rastet per korupsion.
- Shumica e këtyre shkrimeve kanë të bëjnë më me rastin e keqpërdorimit në hekurudha ku vlera është diku mbi 3 milionë euro dhe lënda zvarritet në prokurori , poashtu fshehja e 1.4 milionë euro nga ana e universitetit të prishtinës ndaj thesarit .Aeroporti i Prishtinës dukë punësuar njerëz pa konkurs. Poashtu në kët muaj mediat kanë shkruar për auditimin në ministrinë e drejtësisë dhe atë të kulturës për parregullsi të mëdha
- Shkrimet tjera kanë të bëjnë me afera korruptive nëpër spitale dhe ministri të shëndetësisë dhe KEK

Shtator 2008

- 29 shkrime kryesisht mediat kan paraqitur parregullsitë në ministrinë e shëndetësisë, arrestimet e zyrtarëve të lartë të doganave për shpërdorim të detyrës zyrtare , djegja e dokumenteve të AKM . suspendimi i i zyrtarëve të lartë në ATK .

Tetor 2008

- 9 shkrime për janë fokusuar në auditimin në ministrinë e punëve të brendshme dhe keqpërdorimet në ministrinë e shëndetësisë , keqpërdorimi me prona , keqpërdorimi i barnave në mënyrë ilegale , funksionimi i spitaleve ilegale etj.

Nëntor 2008

Gjithsej 8 artikuj në gazeta;mediat kanë shkruar në këtë muaj kryesisht për mosrespektim e procedurave të prokurimit, keqmenaxhimi dhe keqpërdorimi i pasurive, kontrollet e këqija të brendshme, keqpërdorimet e mjeteve, fshehjet apo moskompletimet e të hyrave dhe shumë t'zeza të tjera e karakterizojnë buxhetin e Kosovës për vitin 2007. Pa lënë jashtë asnjë resor, institucion apo organizatë buxhetore të këtij vendi. Këtë konstatim e ka bërë Zyra e Auditorit Gjeneral të Kosovës për vitin e kaluar. Problemet më të mëdha në të gjitha organizatat buxhetore, ZAP'I i ka gjetur te mospërputhjet me Ligjin mbi Prokurimin Publik. Në shumë raste, kjo është kritikë dhe ka një ndikim material në pasqyrat financiare të atij viti. Aq lëmsh është në këto institucione sa ZAGJ edhe me tutje nuk është në gjendje të mbështetet në aktivitetet e njëjësive të auditimit të brendshëm për të ofruar siguri audituese, se kontrollet e brendshme janë aplikuar në mënyrë të duhur në organizatat e tyre. Të hyrat e këtyre organizatave nuk janë regjistruar në librin kryesor si transaksione të ndara sikurse janë në raportet bankare, por ato janë të përmbledhura në baza ditore apo në periudha më të gjata kohore. Në plotë raste regjistrimet në librin kryesor nuk janë identifikuar edhe në raportet bankare.

Dhjetor 2008

- Gjatë këtij muaji kanë qenë 8 shkrime shkrimet kane të bëjnë me keqpërdorimet në termokos , auditimi në ministrinë e energjisë dhe minierave ku nxjerr shumë shkelje , poashtu auditimi nëpër komuna ku ka nxjerr shumë parregullsi, si tek tenderët poashtu edhe për prona komunale

Në vitin 2008 janë botuar 178 shkrime në mediat e shkruara dhe ato elektronike ,shkrimet kanë të bëjnë me keqpërdorimet e ndryshëm si në tenderë , prona , shpërdorim i detyrës zyrtare dhe auditimet qe janë bërë nëpër institucionet komunale , dhe ato qendrore , keqmenaxhimit , në institucionet si KEK, Aeroport , PTK , Gjykata ,Prokurori, ministri , universitetin e Prishtinës , Termokos, kanë rezultuar me parregullsi sipas mediave.

Për Vitin 2008 për punën e Agjencisë Kosovare KunderKorrupsionit janë botuar gjithsej 140 artikuj ,intervista , opinione. Mbi 98% të këtyre shkrimeve, komenteve, opinioneve, intervistave kane qenë pozitive për punën e AKK-së

iv. Faqja zyrtare e internetit

Faqja zyrtare në internet e AKK-së ka funksionuar gjatë gjithë kohës së periudhës së raportimit. Përmes saj janë përcjell tek publiku i tërë aktiviteti i Agjencionit. Kjo faqe është në dispozicion për çdo moment që të informoheni për çdo gjë që ju intereson lidhur me punën e AKK-së

Te gjithë te interesuarit te cilët do te përdorin këtë faqe do te keni mundësi te marrin informacion për aktivitete te cilat janë ne zhvillim e siper, ato qe janë mbajtur me përpara e cilat do te mbahen ne te ardhmen, përmes një përshkrimi shume profesional te detajuar dhe ne kohe reale.

Faqja zyrtare e Agjencionit Kosovar Kunderkorrupsionit është kjo www.akk-ks.org

v. Aktivitetet dhe Bashkëpunimi

Agjencioni Kosovar Kundër korrupsionit vazhdimisht ka kultivuar frymën e bashkëpunimit të mirë me shumë institucione dhe organizata si vendore ashtu edhe ndërkombëtare.

Në këtë frymë të bashkëpunimit, për ti dhënë ndihmën e duhur Agjencionit në realizimin e misionit të vetë, është krijuar një grup koordinuese të cilin e udhëheq AKK-ja. Ky trup do ta ketë rolin e këshilldhënjes dhe do të merret me

koordinimin e çështjeve të ndryshme që lidhen me misionin e AKK-së, ndërsa përbëhet nga këta mekanizma: Komisioni Evropian, Këshilli Evropian, EULEX-i zyra në Prishtinë e Programit për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara UNDP, Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe bashkëpunim në Evropë OSBE, Njësia e hetimeve Financiare FIU, - (kjo njësi funksionin në kuadër të Guardia Di Finanza), Zyra e Prokurorisë së EULEX-it dhe Qendra e Inteligjencës Financiare FIC. Ky grup do të funksionojë që nga fillimi i vitit 2009.

Për ti dhënë mbështetje AKK-së në ngritjen e kapaciteteve profesionale në gjitha departamentet e tij përmes Komisioni Evropian ka alokuar mjete financiare përmes projektit "Mbështetja për Insitucionet Kundër Korrupsionit në Kosovë", SACIK. Projekti synon që përmes trajnimeve të ndryshme të ndihmojë AKK-në në ngritjen e kapaciteteve profesionale në hetime, parandali dhe edukim.

AKK poashtu ka shprehur gatishmërinë e plotë të kultivimit të bashkëpunimit edhe me institucione dhe organizata vendore.

Në këtë drejtim AKK ka një bashkëpunim të mirë me Qeverinë dhe me konkretisht me Zyren e Kryeministrit-Zyrën për Qeverisje të Mire, ZOM, sidomos në hartimin e Strategjisë kundër korrupsionit si dhe në procesin e filluar për hartimin e planit të veprimit kundër korrupsionit.

AKK ka bashkëpunim të ngushtë edhe me shoqërinë civile dhe mediat. Ato ishin pjesë e rëndësishme e procesit të përpilimit të strategjisë kundër korrupsionit dhe planit të veprimit, dhe do të jenë poashtu bashkëpunor të rëndësishëm në implementimin e këtyre dokumenteve.

Disa aktivitete janë realizuar bashkërisht me shoqërinë civile. Gjatë muajt nëntor dhe dhjetor 2008 AKK në bashkëpunim me "Klubin e Debateve" një organizatë rinore dhe me mbështetjen financiare të UNDP-së janë realizuar pesë debate me qytetar në Prishtinë.

Bashkëpunimi me Asociacionin e Gazetarëve Profesionistë të Kosovës AGPK tash më është bërë tradicional. Me këtë asociacion dhe me ndihmën e UNDP-së është organizuar ceremonia e ndarjes së shpërblimeve për gazetarin hulumtuesë më 9 dhjetor 2008 dita ndërkombëtare kundër korrupsionit.

PROBLEMET

Përkushtimi i Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit dhe puna e vazhdueshme në realizimin e misionit të vetë, nuk ka kaluar pa probleme. Por ndryshe nga vitetë paraprake gjatë këtij vitit problemet nuk kanë qenë të natyrës substanciale, megjithëse edhe këto kanë ndikuar në punën tonë. Të gjitha pengesat do të shtjellohen rrjedhimisht në vijim.

Mungesa e Hapësirës – Në mungesë të objektit publik, AKK-ja e realizon veprimtarinë e vetë në një objekt privat me hapësirë të veçanët e ku kushtet janë minimale për 35 zyrtar sa janë të angazhuar tani dhe dy zyrtar nga projekti i UNDP-se.

Në këtë objekt për të siguruar akomodimin e zyrtarëve AKK ka investuar në improvizimin e 4 zyrave në përdhësen e objektit (salle e cila me herët është përdorur si depo).

Çështja e sigurisë - Për sa i përket aspektit të sigurisë, objekti mbahet nga një kompani e sigurimeve private e paarmatosur kurse pasi që në janarin e vitit 2008 një zyrtar u atakua fizikisht në vendin e punës, AKK-ja në bashkëpunim me Policinë e Kosovës ka siguruar edhe sigurimin e objektit edhe me një polic (pune shtese).

Objekti është i rrethuar me shtëpia private dhe ka parkingun e automjeteve rreth 150 metra larg objektit parkingu është gjithashtu i pasiguruar .

Koordinim jo i mire me prokuroritë - Nga 100 informatat e percjellura ne Prokurori ne i kemi 31 informata kthyses edhe atë ne 19 raste informatat kane rezultuar me ndërmarrjen e masave konkrete te Prokurorisë (ka edhe ngritje aktakuzash) kurse ne 12 raste informatat janë hedhur si te pabaza nga këto 12 refuzime 11 i përkasin vete gjyqësorit.

Kemi edhe raste kur informatat qe i kemi percjellur ne Prokurori dhe te cilat duhet te trajtohen si konfidenciale deri ne momentin e hapjes se procedurës penale ato ju përcillen mediave te shkruara por edhe atyre elektronike.

Kemi edhe raste kur zyrtaret e institucioneve na kontaktojnë duke kërkuar nga ne qe ti pohojmë apo mohojmë informatat qe i kane marre nga te afërmit e tyre neper prokurori dhe te cilat kane te bëjnë me përfshirjen e tyre ne informata qe AKK i ka përcjell ne Prokurori.

Rrezikimi i largimit te personelit - Rrezikshmëri permanente për AKK-ne është largimi i mundshëm i zyrtarëve te cilët bëjnë punë të mundimshme ndërsa aspekti material nuk është në diskrapanc me angazhimet e tyre.

Zyrtaret me lidhjen e kontratës se punës nenshkruajn gjithashtu edhe deklaraten për ruajtjen e sekretit zyrtar dhe ne rast te largimit nga AKK-ja te dhënat –informatat qe i kane marre gjate realizimit te punës s'mund ti keqpërdorim, sidoqoftë vlerësojmë se rritja e pagave kompensime për zyrtaret e Agjencionit do te shtonte motivin për punë dhe do te ngrite interesimin e ekspertëve qe te jene pjese e AKK-se

Ndikimet politike - Janë identifikuar disa raste kur grupe te vogla interesi po tentojnë qe te ndërhyjnë ne punët e AKK-se duke sulmuar ose atakuar punën e saj por qe ne esence kemi te bëjmë me persona qe janë te involvuar ne rastet qe AKK-ja i ka përcjell ne Prokurori.

Mungesa e Legjislacionit - Përvoja e deritanishme e punës dhe dëshira qe ne punën tone te jemi me te suksesshme mendojmë se duhet te ketë edhe ndryshime ne plotësimin e nomenklaturës ligjore dhe atë me:

- ✚ Amendamentimin e Ligjit kundër Korrupsionit;
- ✚ Ligjin për Deklarimin dhe kontrollin e pasurisë;
- ✚ Ligjin për Parandalimin Konfliktit te Interesit

SFIDAT E SË ARDHMËS

Agjencioni kosovar Kundër Korrupsionit gjatë periudhës në vazhdim me përkushtim të plotë do t'iu çaset këtyre detyrave.

Përgatitja e Planit te veprimit kundër Korrupsionit 2009-2011

Pas aprovimit te Strategjisë kundër Korrupsionit nga ana e Kuvendit, detyre parësore e AKK-se do te jete përpilimi i Planit te Veprimit i cili do te përcaktonte me saktësi te gjitha detyrat afatet dhe përgjegjësitë për realizimin e detyrave qe kanë te bëjnë me luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Në faktë procesi i përpilimit të planit të veprimit ka filluar në mes të djetorit 2008.

Ngritja dhe përmirësimi i kapaciteteve hetuese

AKK-ja ka përfituar një projekt nga BE-ja qe ka te beje me ngritjen e kapaciteteve te AKK-se projekti do te zgjas 2 vjet dhe ka vlerën 1.000.000 euro. Nga ky projekt AKK-ja do te përfitojë shume trajnime profesionale ne rende te pare ato ngritjen e kapaciteteve hetuese.

Intensifikimi i aktiviteteve edukuese

Ne bashkëpunim me OSBE-ne do te vizitojmë te gjitha komunat e Kosovës ku do te bisedojmë me shërbyes civil dhe udhëheqës te Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike me qellim te ngritjes se vetëdijes qytetare për domosdoshmërinë e kyçje ne Luftë kundër Korrupsionit.\

Rritja e nivelit dhe fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet qe kane për mision luftën kundër korrupsionit

AKK do te kultivoje marrëdhënie te mira bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare qe kanë për mision luftën kundër korrupsionit, do te bëjmë përpjekje qe me mekanizmat kryesore te lidhin memorandum bashkëpunimi, raporte te veçanta do te realizojmë me Prokurorinë e EULEX-it.

Zbatimi i kuadrit ligjor Anti-korrupsion

AKK-ja vazhdimisht do te jete e përkushtuar ne zbatimin e kuadrit ligjor anti-korrupsion si dhe ti behet i mundur krijimi i mekanizmave te duhur për zbatimin sa me te mire te kësaj baze ligjore.

PËRFUNDIM

Gjate përmbajtjes se misionit ne jemi ballafaquar me situata te vështira dhe shume here te rrezikshme.

Mospërkrahja adekuate, kushtet e vështira te funksionimit, buxheti jo i mjaftueshëm dhe zyrtar te rinj dhe jo me përvojën e duhur ne këtë lëmi e ka vështirësuar disi punën e Agjensionit Kosovar Kundër Korrupsionit.


Me një angazhim shume serioz dhe një fleksibilitet maksimal ne kemi arritur qe te sfidohe mi me te gjitha ato veprime qe pretendohet te jene veprime korruptive.

Rezultatet e deritanishme qe u përmendën ne këtë raport kane shënuar progres ne krahasim me vitin e kaluar por do te jemi edhe me pretendues ne vitin e ardhshëm.

Ne jemi ne fillimin e luftës kundër korrupsionit dhe me nxjerrjen e dokumenteve baze (Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Korrupsionit 2009-2011), me përkrahjen e Institucioneve Qendrore me reformën e përgjithshme te Gjyqësorit dhe me përkrahjen e mekanizmave ndërkombëtare kjo luftë ne vitin 2009 do te jete me e fuqishme dhe me rezultateve.

SHTOJCA 1: ORGANOGRAMI

AGJENSIONI KOSOVAR kundër KORRUPSIONIT DREJTORI I AGJENSIONIT



SHTOJCA 2: LISTA E TRAJNIMEVE

Nr	Lloji i Trajnimit	Organizimi nga	Vendi	Data e fillimit	Data e mbarimit
1.	Hetimi i Shkeljeve Tatimore	AER-i	Prishtinë	14.01.2008	18.01.2008
2.	Harmonising the fight against and corruption in Europe	Dbb Akademie	Gjermani(Cologne)	25.02.2008	26.02.2008
3.	Zhvillimi dhe implementimi i Politikave publike	IKAP-i	Prishtinë	17.03.2008	21.03.2008
4.	Tryezën e Rrumbullaket për Diskutimin e ekspertizës së Këshillit të Evropës	Këshilli i Europës	Strazburg	24.03.2008	27.03.2008
5.	Organizimi i punës	IKAP-i	Prishtinë	25.04.2008	09.05.2008
6.	Anti Pastrimi i Parave dhe gjurmimi i Pasurive	B&S	Prishtinë	07.04.2008	11.04.2008
7.	Organizimi i punës	IKAP-i	Prishtinë	05.05. 2008	06.05.2008
8.	Menaxhimi Strategjik i Anti-korrupsionit	(Hope Felloëship).	Prishtinë	Janar/2008	Prill/2008
9.	Forenziket e TI për hetuesit e Krimet Financiar	AER-i	Vushtrri		
10.	Vlerësimi i nevojave për trajnime	IKAP-i	Prishtinë	19.05.2008	23.05.2008
11.	Anti-pastrimi i parave dhe gjurmimi i pasurisë	AER-i	Vushtrri	13.05.2008	23.05.2008
12.	Fuqizimi i kapaciteteve Kosovare per luftimin e pastrimit te parave dhe korrupsionit	AER-it	Vushtrri	09.06.2008	27.06.2008
13.	Udhëheqja e hetimit të krimit financiar	AER-it	Prishtinë	28.04.2008	02.05.2008
14.	Leadership	Balkan Camp	Greece	10.08.2008	21.08.2008
15.	Anti-Corruption in Public Procurement	CELLI-Institute	Prague	20.10.2008	24.10.2008
16.	Konferenca e 13 Anti-korrupsion	UNDP USAID etj	Athine	28.10.2008	04.11.2008
17.	Procedurat e Vlersimit	IKAP	Prishtinë	16.11.2008	18.11.2008
18.	Ëindoës EP, Internet	IKAP	Prishtinë	13.11.2008	26.11.2008
19.	Interpretimi I Ligjit	IKAP	Prishtinë	24.11.2008	25.12.2008
20.	Rregullorja 2001/36 mbi SHCK dhe procedurat e personelit	IKAP	Prishtinë	13.11.2008	19.12.2008
21.	Anti-Corruption Program	USAID	Prishtinë	shtator 2007	qershor 2008
22.	Tryezë e rrumbullakë mbi Anti-korrupsionin	UNDP	Bratislavë	09.07.2008	12.07.2008
23.	Teknologji Informative	IKAP	Prishtinë	23.09.2008	07.10.2008
24.	Teknologji Informative	IKAP	Prishtinë	23.09.2008	07.10.2008
25.	Teknologji Informative	IKAP	Prishtinë	20.10.2008	04.11.2008
26.	Teknologji Informative	IKAP	Prishtinë	20.10.2008	04.11.2008